



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 239, datë 25.11.2019

**PËR EMËRIMIN SI PROKUROR NË PROKURORINË E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Bazuar në nenin 148/dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48/1, 163/2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 4, nenin 12 të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë pasi ka verifikuar plotësimin e të gjitha kushteve dhe kritereve të parashikuar në ligjin nr.95/2016 dhe në referencë të vendimit të tij, nr.137 datë 16.07.2019 “Për miratimin e listës me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme”,

V E N D O S I:

1. Të emërojë si prokuror në Prokurorinë e Posaçme Znj. Enkeleda Millonaj për një mandat 9 (nëntë) vjeçar pa të drejtë riemërimi.
2. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe prokurori Enkeleda Millonaj.
3. Ky vendim hyn në fuqi më datën 19 dhjetor 2019 dhe botohet ne faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETARI
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BEJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR
ARBEN DOLLAPAJ**

**ANËTAR
ESMERALDA CAMI**

**ANËTAR
BESNIK CANI**